

Nr. ____ Prot

Tiranë, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)
OBJEKTI I PROCEDURËS: **“F.V MOBILIMIN E PLOTË PËR ZYRAT E BANKËS
SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT SHA”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Mobilje kompjuteri 39134000-0 , Mobilime të ndryshme 39290000-1

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **8,546,904 (tetë milion e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e katër) Lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: Të ardhurat e AK Banka Shqiptare e Zhvillimit sha

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër ose afati i zbatimit të kontratës: 30 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Banka Shqiptare e Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga struktura e posacme e ngjitur me Urdhërin e Titullarit të AK Nr.85 datw 21.07.2026 dhe janë si vijon:

I. Hartimi i specifikimeve teknike

Grupi i punës hartoi specifikimet teknike duke u mbështetur në:

- a) nevojat funksionale të strukturave organizative të Bankës;
- b) organizimin dhe shfrytëzimin racional të ambienteve të punës;
- c) numrin aktual dhe të planifikuar të punonjësve;
- d) standardet ergonomike dhe kërkesat për sigurinë dhe komoditetin në punë;
- e) kërkesat për cilësi, jetëgjatësi dhe rezistencë të mobiljeve;

- f) praktikat më të mira të arredimit të institucioneve publike dhe financiare.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që të garantojnë konkurrencë të hapur ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke respektuar parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, pa përfshirë kërkesa që favorizojnë marka, prodhues apo origjinë të caktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Më poshtë do të gjeni tabelën me sasi dhe specifikimet:

Nr	Emërtimi artikullit	Njësia	Sasia
1	Tavolinë për gjashtë (6) persona me përmasat 360x120 x 73H	Copë	6
2	Tavolinë për katër (4) persona me përmasa 240x160x73h katërshe	Copë	1
3	Ndarëse me xham për tavolinat me përmasa 120x35H	Copë	20
4	Komodinë me tre (3) sirtarë metalikë me çelës	Copë	48
5	Karrige ergonomike me mekanizëm	Copë	60
6	Tavolinë me përmasa 160x80x73H	Copë	5
7	Bibliotek me sergjen 80x200h me porta e mbyllur 200h me celes	Copë	14
8	Bibliotek me sergjen 40x200h me porta e mbyllur 200h me celes	Copë	3
9	Aksesorë për Varjen e rrobave rroba	Copë	15
10	Bibliotek me përmasa 120x 40x120H	Copë	4
11	Bibliotek me përmasa 40x 40x120H	Copë	2
12	Bibliotek me përmasa 80x40x80H	Copë	5
13	Bibliotek me përmasa 80x40x120ë me porta 80-ce + porta xham	Copë	8
14	Tavoline me përmasa 200x200 forme L	Copë	1
15	Karrige ergonomike drejtuesi	Copë	1
16	Komodinë me 3+1 sirtarë, me rrota, me mbyllje qendrore me çelës	Copë	1
17	Kolltuk zyre tek	Copë	1
18	Kolltuk zyre dysh	Copë	1
19	Kolltuk zyre tresh	Copë	1
20	Tavolinë mesi suprinë me xham 90x60x73H	Copë	1
21	Karrige statike me krah strukturë inox dhe lekur ekologjike	Copë	18
22	Tavolinë form L me përmasa 170x90x73H	Copë	2
23	Tavolinë 120x80x73H (Arkivi)	Copë	1
24	Stol i lart termoplastik	Copë	8
25	Tavolinë e lartë me përmasa 180x70x110H	Copë	1
26	Rafte metalik për zyrë arkivi	Copë	7
27	Dollap kundër zjarri metalike 80x40x200H	Copë	1
28	Dollap me sirtarë kundër zjarri 150x 60x80	Copë	1
29	Reception me logo dhe me përmasa 2550X1200X1020H	Copë	1
30	Tavolinë për sallën e mbledhjeve me dimesione 360x 120x73H	Copë	1

1. Tavolinë për gjashtë (6) persona me përmasat 360x120 x 73H copë 6**2. Tavolinë për katër (4) persona me përmasa 240x160x73h katërshe cope 1**

Specifikime për artikullin 1&2:

- a) Përmasat totale (cm): 360 (Gj) x 160 (Th) x 73 (L) (për 6 punonjës në total);
- b) Suprina e tavolinës duhet të jetë me trashësi 18mm;
- c) Këmbët e tavolinës duhet të jenë të përbëra nga metal në formë drejtkëndore, me përmasa 45x45 mm, spesor 2 mm dhe të jenë të lyera me bojë. Fundi i këmbëve duhet të jetë me mbështetëse prej materiali poliamid për mbrojtjen ndaj gërvishtjeve dhe rrëshqitjes;
- d) Secili prej 6 posteve të punës duhet të jetë i ndarë balle per balle me panel ndarje veshur me cope ;
- e) Materiali i suprinës: Melaminë E1;
- f) Ngjyra e suprinës: e bardhe e piset
- g) Ngjyra e strukturës metalike: e bardhe



**Foto ilustruese*

3.Ndarëse me xham për tavolinat me përmasa 120x35H sasia 20 copë

Ndarjet e montuara në tavoline janë të disponueshme në lartësi 350 mm dhe janë montuar nësipërfaqet e suprinës të tavolines së zyrës përmes pajisjeve të derdhura prej alumini.B.1.2. Ato mund të lidhen së bashku për të formuar një kryq, një "T" ose në një rresht të drejtë.B.1.3. Të gjitha kornizat mund të kenë një profil të brendshëm i cili mund të mbështesë aksesorët ndihmës të zyrës ..B.1.4. Profilet e kornizës së aluminit janë të disponueshme në ngjyrë të anodizuar.B.1.5. Ndarjet e montuara në tavoline mund të kenë panele të materialeve të mëposhtme: · · Xham transparent ose xham i mjergullt (film ose kimik)·

Paketimi: karton

Paketimi: 1 copë ndarje e montuar në tavoline 1200x350H mm

Pesha: 10 kg

Vëllimi: 0,02 m



**Foto ilustruese*

4. Komodinë me 3 (tre) sirtare metalikë me celës sasia 48 copë

Përmasat: (43 gj x 58 th x 54 l) cm

Struktura e komodinës do jetë materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të të gjitha paneleve vertikal dhe horizontal 15-20 mm. Sirtariera duhet të ketë 4 rrota në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë dhe te pajiset me frena për të mos levizur.. Sirtari i parë nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 2 sirtarë të barabartë përberja e brendshme e tyre të jetë me material metalik. Sirtarët duhet të jenë të pajisur me kyç që të realizojë mbyllje qendrore. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës. Veshja duhet të sigurojë rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet e fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Ngjyra të jetë e njëjte me tavolinën e punës.

Paketimi i një komode melamine me shinat udhëzuese teleskopike, me dimensione 433x589x545H

Pesha: 35,0 kg

Vëllimi: 0,16 m³

Paketat: 1



**Foto ilustruese*

Shembull sirtari i parë lart

5.Karrike ergonomike me mekanizëm sasia 60copë

Karrige rrotulluese zyre (me rrota).

Të dhënat teknike.

Baza e yllit të karriges duhet të ketë një diametër prej jo me pak se 660 mm prej alumini të derdhur. Të përfundimi i sipërfaqes mund të jetë ose i lyer me pluhur ose i lëmuar.

Me rrota dyshe prej poliamidi, me mbulesë mbrojtëse nga i njëjti material.

Aktivizimi i ngritjes së gazit të rregullimit të lartësisë te arrihet përmes një levë e cila është e aksesueshmeanash nën sedilje. Gama e mekanizmit të rregullimit të lartësisë te jete jo me pak se 120 mm.

Mekanizmi i ndenjësve, të jetë sinkro-mekanizëm që lejon dinamikën e njëkohshme, lëvizja e sediljes me 11° dhe e mbështetëses me 18° dhe të sigurojë 5 pozicione kyçjeje. Të mekanizmi te kete funksion "anti-paniku" dhe te mund të rregullohet sipas përdoruesit. Aktivizimi dhe çaktivizimi i lëvizjes Synchro te arrihet përmes të njëjtës levë që përdoret për rregullimin e lartësisë së sediljes. Rregullimi i peshës të arrihet përmes një rregullatori vidë e cila është e vendosur përpara dhe nën zonën e sediljes.

Pllaka e ndenjës prej poliamidi termoplastik (PA6). Në pjatën e ndenjës te shtrihet jastëk i bërë nga shkumë poliuretani i zgjeruar me trashësi jo me pak se 60 mm, i cili te jete i veshur me susta dhe pelhure. Duhet te disponoje një mundësi për të rregulluar thellësinë e pllakës së ndenjës nga 0-60 mm dhe të sigurojë 7 pozicione kyçjeje.

Dimensionet e sediljes: gjerësia jo me pak se 460 mm, thellësia jo me pak se 410 mm.

Mbështetësja te jetë një kornizë anatomike e kryqit ovale të formuar dhe të salduar, seksion 25 X 10 X 1,5 mm profile çeliku, mbi të cilat vendoset një rrjetë e brendshme në një mënyrë që të shpërndajë presionin në mënyrë të njëtrajtshme. Shpina te përmbaje gjithashtu një suport mesi që mund të rregullohet në lartësi me 70 mm. Përmasat e mbështetëses: lartësia 670 mm, gjerësia 430 mm. Vishet me rrjetë.

Mbështetësit e krahëve të ndenjësve të jenë prej poliamidi termoplastik dhe të rregullueshëm në lartësi.

Gama e rregullimit mm (145-235 mm nga sedilja). Pjesa e sipërme e krahëve të ketë një dimension 240 x 115 mm dhe të mund të rrotullohet +/- 5°. Sipërfaqja e kontaktit të krahëve te përbëhet nga poliuretani i derdhur me fortësi mesatare për komoditet dhe ergonomi më të madhe dhe gjithashtu të lëvizet përpara dhe mbrapa në 6 pozicione (5

shkallë). Duhet të jetë e mundur të lëvizën krahët në të gjithë gjerësinë e diapazonit të rregullimit 450-540 mm.

Paketimi 1 copë në kuti kartoni

Pesha: te paktën 15 kg

** Foto ilustruese te mekanizmave ergonomik, personalizim sipas fizikut te punonjësit. Përmasat ne cm si me poshtë.*



6. Tavinë me përmasa 160x80x73H sasia 5 copë

Tavolina pune është bërë nga dërrasë druri 38 mm e veshur me rimeso natyrale ose e veshur me llak. Paneli ballor i tavolinës është bërë nga dërrasë druri 25 mm me lyster llak të bardhë. Në sipërfaqen e tavolinës ka dy rozeta për kalimin e kablllove, të veshura me nikel ose të lyster, dhe një kanal për kalimin e kablllove mund të vendoset opsionalisht nën sipërfaqe. Të dyja ndihmojnë në organizimin e sipërfaqes së punës dhe për një siguri më të madhe.

NDËRTIM I FORTË – I bërë tërësisht nga dërrasë druri melamine 38 mm dhe 25 mm e kombinuar me materialet e cilësisë më të lartë.



*Foto ilustruese

7. Biblotek me sergjen 80x200 H me porta e mbyllur 200 H me celës sasia 14 copë

8. Biblotek me sergjen 40x200 H me porta e mbyllur 200 H me celës sasia 14 copë

Specifikime për artikullin 7&8:

Struktura e bibliotekës duhet të jetë me material komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të mureve 18 mm, gjerësia 18 mm, dhe raftet 22 mm. Bibloteka të ketë dy kanate me porta të mbyllura dhe celës dhe rregullator nivelimi nga 0 – 10 mm me rregullim shtesë të brendshme. Ngjyra sipas tavolinës së punës.



*Foto ilustruese

9. Aksesorë për varjen e rrobave sasia 15 copë

Varëse rrëshqitëse

Varëse rrëshqitëse për vendosje në pjesën e brendshme të dollapëve. Veçanërisht e dobishme për ruajtjen e sigurt të rrobave. Gjithashtu e përshtatshme për rroba të rënda.

Zgjatje nga 310 në 490 mm

Montim i lehtë dhe i shpejtë në çdo lloj dollapi



*Foto ilustruese

10. Biblotek me përmasa 120 x 40 x 120H Sasia 4 copë

11. Biblotek me përmasa 40 x 40 x 120H Sasia 2 copë

Specifikime për artikullin 10&11:

Struktura e bibliotekës do jetë materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të mureve të 18mm, gjerësia e 18mm, dhe raftet e 22mm. Bibloteka të ketë dy kanate me porta të mbyllur dhe celes dhe pjesa e sipërme 40cm h të jetë me porta xham akull dhe kornize alumini për të qenë kompakte dhe kundër thyerrjes së xhamit, pjesa e brendshme me raftet me raftet të kenës regullator nivelimi nga 0 – 10 mm me rregullim shtesë të brendshme. Ngjyre sipas ngjyrës së tavolinës së punës.



12. Biblotek me përmasa 80 x 40 x 80H Sasia 5 copë

Struktura e bibliotekës do jetë materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të mureve të 18mm, gjerësia e 18mm, dhe raftet e 22mm. Bibloteka të ketë dy kanate me porta të mbyllur. Ngjyre sipas ngjyrës së tavolinës së punës.



**Foto ilustruese*

13. Bibloteka me permasa 80x40x120H me porta 80-ce + porta xham lart sasia 8 copë

Struktura e bibliotekes do jetë materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të mureve të 38 mm, gjerësia e 18mm dhe raftet e 22mm. Bibloteka te kete dy kanate me porta e mbyllur dhe celes dhe pjesa e sipërme 40cm h te jete porte xham me profil alumini korniza e saj pjesa e brendshme me rafte me rafte te kenë regullator nivelimi nga 0 – 10 mm me rregullim shtesë të brendshme. Ngjyre sipas ngjyres se tavolines se punes.

14.Tavoline forme L me ballore dhe anesore xham permasa 200x200 sasia 1 copë

Të gjitha majat e tavolinës kanë një trashësi prej 38 mm (25 mm për panelin modest) dhe janë bërë prej film me dy nivele melamine të veshura me chipboard E1 me tre shtresa.

Skajet e dukshme janë të mbuluara me fashë lidhëse me trashësi 2 mm, ndërsa skajet jo të dukshme, janë te mbuluar me fashë lidhëse me trashësi 0,45 mm.

Ndarja e kabllave është e mundur përmes një grommeti kabllor në sipërfaqen e suprines dhe kanalit kabllor brenda panelit ballor ose nën sipërfaqen e suprines (opsionale).

Cdo këmbë anësore ka në pjesën e poshtme, dy rrëshqitje alumini në formën "II".


Paneli ballor mund të bëhet ose nga chipboard melamine me trashësi 25 mm, ose me 25 mm

chipboard i trashë melamine me një sipërfaqe shtesë të pastër prej qelqi të ngjitur me trashësi 4 mm mbi të.

Sipërfaqja ndihmëse 60x200, me ndarës të përshtatshëm të bërë nga poliamid i përforcuar duhet të ketë një shtesë sipërfaqe e pastër qelqi me trashësi 4 mm, të llakuar ose transparente, të ngjitur në të.

Pesha: 121,0 kg

Vëllimi: 0.28 m³



Dimensionet :


**Foto ilustruese*

15. Karrige ergonomike drejtuesi sasia 1 copë

Baza e karriges duhet të ketë një diametër prej jo më pak se 660 mm në formë 5 yje. Në mekanizmin e karriges duhet të jetë vendosur aktivizimi i ngritësit të gazit rregullues sipas lartësisë. Pistoni i gazit për rregullimin e lartësisë së sediljes aktivizohet nga një levë e vendosur nën dhe anash sediljes.

- Mbështetësja e karriges duhet të jetë me mekanizëm Synchro, që lejon lëvizjen dinamike të njëkohshme të ndenjës dhe mbështetëses, që të mund të rregullohet sipas peshës së përdoruesit duke u pozicionuar në të paktën 2 (dy) nivele. Korniza e Mbështetëses të jetë e përbërë nga profile poliamide termoplastik për shpërndarjen e presionit, që të sigurojë rehati dhe ergonomi maksimale. Mbulesa e pasme e mbështetëses, të jetë e përbërë nga një kornizë anatomike nga profilet e poliamidit, mbi të cilat të vendoset një mbështetëse me përbërje lëkurë ekologjike, si dhe ndenjese lëkurë ekologjike, e njejte (ngjyrat sipas kërkeses së Autoritetit Kontraktor pas lidhjes së kontratës).

- Ndenjësja e karriges të jetë e përbërë nga poliamid termoplastik dhe jastëku të jetë i mbushur me shkumë poliuretani, dhe mbulesa e jastëkut të jetë me lëkurë artificiale/prodhuar, dhe mekanizëm lëvizje për rregullim pozicioni (të rreshqasë horizontalisht në thellësi) në të paktën 3 nivele nëpërmjet një leve e vendosur nën/anash sediljes dhe e lehtë në përdorim.
- Krahët e karrigeve të jenë të përbërë nga poliamidi termoplastik dhe i rregullueshëm në lartësi. Pjesa e sipërme e krahëve të mund të rrotullohet (majtas-djathtas), të ketë përbërje poliuretani i hedhur me fortësi të mesme për rehati maksimale, ergonomi si edhe mundësi të zhvendoset para-mbrapa në të paktën 2 (dy) pozicione.
- Koka e karriges të ketë mekanizëm të lëvizshëm dhe të lëvizë lart-poshtë, në të paktën 2 (dy) nivele dhe jastëku të jetë i mbushur me shkumë poliuretani, dhe mbulesa e jastëkut të jetë me lëkurë artificiale/prodhuar.
- Karrigia të ketë kokën dhe ndenjësen me tapiceri të të njëjtës material, me lëkurë artificiale/prodhuar.
- Dimensionet (ne cm) te jene sipas skicës ilustruese.



Mekanizmat ilustruese personalizuese te karriges ergonomike:



Leva per lartesine.



Mekanizmi per ndalimin ne kendin e duhur te perdoruesit.



Rregullatori i peshes sipas perdoruesit.



Butoni per rregullimin e thellesise se ndenjeses.



rregullimi i kraheve (4D)



rregullimi i suportit per qafen larte ose poshte

16. Komodinë me 3+1 sirtare , me rrota me mbyllje qendrore me celës

- a) Përmasat (cm): (43 (Gj) x 58 (Th) x 54 (L);
- b) Struktura e komodinës, të jetë me trashësi të të gjitha paneleve vertikal dhe horizontal 15 - 20 mm. Komodina duhet të ketë 4 rrota në mënyrë që të mund të lëvizë si dhe të jetë e pajisur me frena në mënyrë që të qëndroj e palëvizshme;
- c) Sirtari i parë lart duhet të jetë i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, me përbërje të brendshme material metalik. Sirtarët duhet të jenë të pajisur me kyç duke realizuar mbyllje qendrore edhe për sirtarët e tjerë të komodinës;
- d) Aksesorët përbërës duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të lartë të komodinës. Materiali duhet të sigurojë rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve, njollave dhe lagështirës;
- e) Ngjyra: lis;
- f) Materiali: Melaminë E1.



**Foto ilustruese*

17. Kolltuk tek sasia 1 copë

18. Kolltuk dysh sasia 1 copë

19. Kolltuk tresh sasia 1 copë

Specifikime për artikullin 17, 18 & 19:

Korniza dhe këmbët janë prej tub çeliku të rrumbullakët me diametër 26 mm dhe trashësi 2 mm.


Te cilat mund të jenë të veshura me pluhur ose të veshura me nikel.

Këmbët kanë rrëshqitje plastike për mbrojtjen e dyshemesë.



Sedilja, mbështetësja dhe mbështetësit e krahëve prej druri, montohen në kornizën metalike dhe mbulohen me shkumë poliuretani të zgjeruar dhe të veshur me material të zgjedhur nga katalogu. Jastëkët për sediljen dhe mbështetësen janë prej poliuretani të zgjeruar me densitet të lartë shkumë dhe janë të veshura me material të zgjedhur nga Pëlhura-Lëkurë



Modeli Dysh Dimendione:



Modeli tek Dimensione:



modeli Tresh

**Foto ilustruese*

20. Tavoline mesi suprine xham 90x60x73cmh sasia 1copë

Tavoline mesi suprina te jete xham i temperuar ngjyre te zeze , me dimensione 90x60 dhe larteni 38cm, struktura e kembes te jete konstrukt metal me kater kembe perberje inox.



**Foto ilustruese*

21. Karrige statike me krah strukture inox dhe lekure ekologjike e zeze sasia 18 copë

Korniza është prej tub çeliku me seksion kryq të rrumbullakët me diametër 26 mm dhe 2 mm

trashësi, e formuar në formë “S”.

Ndënjëse është prej fletë druri, e formuar dhe e ngjitur me presion në një trashësi 12mm.

Mbi ndenjësën vendoset jastëk me shkumë poliuretani me trashësi 10 mm e cila më pas mbulohet

me tapiceri sipas zgjedhjes së autoritetit kontraktor. Mbështetësja është e disponueshme në dy variante.

o Në të parën mbështetësja është e punuar me seksione çeliku të formuara dhe të salduara dhe është

veshur me pëlhurë gome. Në pllakën e mbështetëses shtrihet një jastëk i bërë nga

shkumë poliuretani i zgjeruar me 10mm i cili është i veshur me susta nga të dyja anët me pëlhurë e zgjedhur.

o Në të dytin, pjesa e pasme është e formuar dhe ngjitur me seksione çeliku

në të cilën vendoset një rrjetë, në mënyrë të tillë që presioni të shpërndahet në mënyrë të barabartë.

Karrigia ka mbështetëse krahësh të bërë nga poliuretani i zi me fortësi mesatare.

Karrigia është e stivueshme.

Dimensionet e sediljes: gjerësia 480 mm, thellësia 470 mm.

Dimensionet e mbështetëses: gjerësia 460 mm, thellësia 590 mm .

Baza është e pajisur me aksesore kundër rrëshqitjes dhe mbrojtëse për dyshe-menë.

Karrige statike me krah



*Foto ilustruese

Suport anatomik :



Dizajni anatomik i sedijes sipas standardeve ergonomike EN .

Dimensionet:
PESHA: 10kg



22. Tavolinë në form L me përmasa 180 x 70 x 73H sasia 2 copë

Të gjitha suprinat e tavolinës duhet të kenë një trashësi prej 38 mm , të përbëra me film me dy nivele melamine të veshura me chipboard E1 me tre shtresa. Skajet e dukshme të jenë të mbuluara me fashë lidhëse me trashësi 2 mm, ndërsa skajet jo të dukshme me fashë lidhëse me trashësi 0,45 mm. Ndarja e kablllove të bëhet e mundur përmes një pajisje kablllore në sipërfaqen e suprinës. Cdo këmbë anësore të ketë në pjesën e poshtme dy rrëshqitje alumini në formën "II".

Paneli ballor mund të bëhet ose nga 25 mm me trashësi chipboard melamin.

Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Nuk duhet të duken vidat e bashkimit. Tavolina të projektohet në një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit gjatë përdorimit. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Të jetë i mundur kalimi i kablllove .

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë, vidat të mos duken. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojnë kushtet e fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi.



Modeli sipas skicës ilustruese.

23. Tavolinë 120 x 80 x 73H sasia 1 copë

Tavoline zyre me suprine të bëra nga chipboard me 3 shtresa të veshura me film melamine me dy anë E1

dhe: kornizë me lartësi konstante e bërë prej çeliku të veshur me pluhur.

Për të gjitha versionet e tavolinave të zyrës ekziston një kornizë mbështetëse horizontale e bërë nga tuba çeliku me prerje tërthore drejtkëndëshe 20x40x2 mm.

Këmbët e tavolinës, në varësi të versionit, janë:

për tavolina me lartësi konstante, prej tubash çeliku të veshur me pluhur me prerje katrore 45x45x1,5 mm

Pjesa e sipërme e tavolinës ka një trashësi prej 18 mm dhe është e bërë me film melamine të veshur me dy anë. chipboard me 3 shtresa E1. Ata kanë buzë plastike me trashësi 2 mm përgjatë perimetrit të tyre, e rrumbullakosur në mënyrë ergonomike në R2 mm. Të gjitha versionet e tavolinave të zyrës janë të pajisura me vida rregulluese të lartësisë për nivelim, me një diapazoni i rregullimit prej 0-25 mm. Të gjitha versionet e tavolinave të zyrës mund të mbajnë panele ose ballore të bëra nga melamine me trashësi 18 mm chipboard, si dhe kanalet e menaxhimit të kablllove dhe prizat e prizës së kablllove.

**Foto ilustruese*



24. Stol i lart termoplastik sasia

Stoli ka një kornizë moderne, të lartë dhe të kromuar. Është formuar me shumë kthesa dhe një dizajn modern. Ka tapa anti-rrëshqitëse për të mbrojtur dyshtemenë dhe është projektuar dhe ndërtuar për të ofruar stabilitet maksimal. Ndenjese është bërë nga polipropilen i bardhë i riciklueshëm.

Kornizë moderne e kromuar

Ndërtim i qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë

Tapa anti-rrëshqitëse



**Foto ilustruese*

25. Tavolinë me permasa 180x70x110h sasia 1 copë

Përmasa të përgjithshme: 1800 mm (gjatësi) x 700 mm (gjerësi) x 1100 mm (lartësi).

Konstruksion i qëndrueshëm prej paneli melamine me dendësi të lartë.

Trashësia e sipërfaqes së tavolinës minimum 25 mm.

Skajet e përfunduara me shirit ABS rezistent ndaj goditjeve dhe konsumit.

Kornizë dhe elemente mbajtëse të dimensionuara për përdorim intensiv në ambiente zyre.

E pajisur me traversë metalike horizontale për rritjen e stabilitetit strukturor.

Sipërfaqe rezistente ndaj gërvishtjeve, njollave dhe lagështisë.

Këmbë të pajisura me nivelues për kompensimin e parregullsive të dyshemesë.

Dizajn modern, i përshtatshëm për zona bashkëpunimi, takime informale dhe ambiente pushimi.

Ngjyra e bardhe.



**Foto ilustruese*

26. Rafte metalik për zyrë arkivi sasia 7 copë

Përmasa në cm: 100 gjerësi x 40 thellësi x 200 lartësi

Materiali të jetë llamarinë e cilësisë së parë. Lyerja të realizohet me pluhur elektrostatik të tipit epoksi-poliester dhe të trajtohet paraprakisht me fostat hekuri. Ngjyra të jetë gri ose alumini.



**Foto ilustruese*

27. Dollap kundër zjarri metalike sasia 1 copë

Dollap metalik me dyer të plota 80 x 40 x 200H cm

Konstruksion i realizuar nga llamarinë çeliku me rezistencë të lartë.

I pajisur me dy dyer metalike me hapje frontale.

Sistem mbylljeje me bravë dhe dy çelësa.

Minimumi 4 rafte të brendshme të rregullueshme në lartësi.

Kapacitet mbajtës i përshtatshëm për dosje, dokumente dhe materiale zyre.

Sipërfaqe e trajtuar kundër korrozionit dhe e lyer me bojë elektrostatische pluhur.

Këmbë ose bazament i qëndrueshëm për përdorim afatgjatë.

Ngjyra gri ose sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.



**Foto ilustruese*

28. Dollap me sirtare kundra zjarri 150H x 60 x 80

Trashësia e mureve 60 mm, Trashësia totale e derës mbi 70 mm, 4 sirtarë të brendshëm për skedarë, Një kasafortë e brendshme me çelës,

Sirtarët me mbyllje të veçantë si dhe me mbyllje qendrore për tërë sirtarët, Mundësi të përshtatjes për skedarë të dimensioneve A3 dhe A4;

Sirtarët janë me mekanizëm “Anti tilt”,

Dera e jashtme e pajisur me mentesha masive të jashtme të sigurisë së lartë;

Rezistentë ndaj thyerjes;

Reziston në zjarre për një periudhë së paku një (1) orë;

Mekanizëm sigurie vetëmbyllëse (rilocker) që aktivizohet me rastin e tentimit të hapjes me dhunë;

6 shula dere 22 mm; Mundësi ankerimi në tokë;

Mekanizmi i mbylljes me: PulsPro bravën elektronike e sigurisë së lartë me audit nga Tecnosicurezza/GUNEBO,

Mbyllja qëndrore me bravën elektronike të sigurisë së lartë e certifikuar me standardin EN-1300;

Master kodi, menaxher kodi dhe 49 shfrytëzues

Bllokim i derës në rast të tentimit të hapjes nga personat e pa autorizuar; Mbyllje kohore Time delay 1-99 minuta; Koha e hapjes 1-19 minuta; , Bllokim i derës (dënim) nëse tentohet të hapet dera nga personat e pa autorizuar ose nëse gabohet kodi gjatë 3 përpjekjeve të gabuara;

Çelësi Dallas ose ekuivalent;

Mundësi e hapjes me dy palë kode (principi i katër syve);

Memorizimi i hapjeve dhe kohës së mbylljes nga personat e autorizuar dhe atë me datë dhe orë/minuta (së paku 5000 ngjarjet e fundit)

Dimensionet:

Lartësia 150 cm x Gjerësia 59 cm x Thellësia 77 cm



**Foto ilustruese*

29. Reception me logo dhe permasa 255 x 120 x 102H

1.Reception për ambiente administrative, zyra, institucione publike ose private, me dizajn ergonomik dhe estetik. Struktura përbëhet nga tavolina e punës, paneli frontal dekorativ dhe sporteli i ngritur për pritjen e klientëve.

2. Dimensionet

- * Gjatësia totale: 2550 mm
- * Thellësia totale: 1200 mm
- * Lartësia e tavolinës së punës: 730 mm
- * Lartësia totale e recepsionit: 1020 mm
- * Toleranca e dimensioneve: ± 10 mm

3. Materiali

- * Konstruksioni kryesor: MDF ose chipboard melaminuar, trashësi minimale 25 mm.
- * Panelet dekorative dhe anësore: MDF melaminuar 18–25 mm.
- * Bordurat: PVC ABS 2 mm, rezistente ndaj goditjeve dhe lagështisë.
- * Sipërfaqet të jenë rezistente ndaj gërvishtjeve, njollave dhe konsumit të përditshëm.

4. Struktura dhe funksionaliteti

- * Tavolinë pune ergonomike me hapësirë të mjaftueshme për kompjuter dhe pajisje zyre.
- * Sportel i ngritur për komunikim me klientët.
- * Panel frontal dekorativ sipas modelit
- * Hapësirë e brendshme për menaxhimin e kablllove.
- * Bazament me nivelues për korrigjimin e pabarazive të dyshemesë.

5. Aksesore


- * Fiksues metalikë të galvanizuar.
- * Vida dhe lidhëse të fshehura.
- * Kanal kabllor PVC ose metalik.
- * Nivelues plastikë ose metalikë në pjesën e poshtme.

6. Ngjyra

- * Kombinim ngjyrash sipas modelit të paraqitur në katalog.
- * Ngjyra përfundimtare të përcaktohen nga autoriteti kontraktor para prodhimit.

7. Cilësia dhe montimi

- * Të gjitha skajet të jenë të borduara me PVC.
- * Sipërfaqja të jetë uniforme, pa deformime, çarje apo dëmtime.
- * Montimi dhe çmontimi të realizohet lehtësisht pa dëmtuar elementet përbërëse.



Right

30. Tavolinë për sallën e mbledhjeve me dimesione 360 x 120 x 73H

Kapaciteti: Minimum 10–12 persona.

Forma: Ovale me skaje të rrumbullakosura.

Sipërfaqja e tavolinës: E realizuar nga panel Thermolaminat ose ekuivalent, me trashësi minimale 25 mm, rezistente ndaj gërvishtjeve, goditjeve, lagështisë, njollave dhe rrezeve UV, e përshtatshme për përdorim intensiv në ambiente zyrash.

Këmbët mbajtëse: Cilindrike, të veshura me PET Felt ose material ekuivalent me veti akustike, me trashësi minimale 18 mm, i përbërë nga fibra PET të ricikluara dhe të virgjëra, që kontribuon në absorbimin e zhurmës dhe përmirësimin e akustikës së ambientit.

Menaxhimi i kablllove: Tavolina të jetë e pajisur me hapësirë ose sistem për kalimin e kablllove elektrike dhe të të dhënave (cable management).

Stabiliteti: E pajisur me nivelues në bazë për kompensimin e pabarazive të dyshemesë.

PËR TË GJITHË ARTIKUJT E KËRKUAR MË SIPËR, PËRMASAT E PËRCAKTUARA PRANOHEN ME NJË TOLERANCË DIMENSIONALE PREJ $\pm 5\%$.

I. KRITERET E KAPACITETIT TEKNIK

Grupi i punës, vijoi me përcaktimin e kriterëve të kapacitetit teknik, si një masë e nevojshme për të garantuar furnizimin dhe vendosjen në gjendje pune të pajisjeve dhe artikujve objekt prokurimi.

Ndërkohë, njësia e prokurimit argumenton ligjërisht kriteret si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4, në vlerë 170,940 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet) Lekë.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së

Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9. *(për secilin lot)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 1.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), në vlerë sa 39% të fondit limit të procedurës së prokurimit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, fond i cili është nën kufirin e ulët monetar dhe zbatohen përcaktimet e nenit 49 të LPP dhe 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Konkretisht vlera e xhiros së kërkuar është mbështetur në pikën 4 të nenit 55 dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP të ndryshuar.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e fondit limit të procedurës së prokurimit ose 1,623,911 (një milion e gjashtëqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, lloji i mallrave dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe në nenin 55, pika 4, shkronja b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Grupi i punës argumenton se kriteret e kapacitetit teknik i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu garantuar paraprakisht për aftësinë zbatuese dhe disponimin e burimeve njerëzore të kualifikuara nga operatori ekonomik.

Ndërkohë njësia e prokurimit, i gjen të bazuara në LPP dhe RrPP kërkesat teknike të nëposhtme.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë ” (e vlefshme) ose ekuivalent;

ISO 45001:2018 : 2015, për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë , ose ekuivalente

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Si dhe mbështetur në nenin 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga

madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i kontratës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të nënshkruajë specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën minimale 2 vjeçare të garancisë së mallrave objekt prokurimi, nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende në adresën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës konfirmon se artikujt objekt i prokurimit do të jenë të reja, të papërdorura më parë, të prodhuar sipas standardeve të cilësisë në fuqi dhe pa asnjë lloj dëmtimi estetik apo strukturor.

Argumentimi: Këto kritere janë përcaktuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe pikën 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përmes nënshkrimit të specifikimeve teknike nga ana e operatorëve ekonomikë dhe vetëdeklarimit në Formular Vetëdeklarimi për plotësimin e specifikimeve teknike, AK disponon një panoramë më të qartë të kuptueshmërisë së objektit të prokurimit dhe marrjes përsipër në mënyrë të qartë të realizimit të objektit të prokurimit nga operatori ekonomik fitues.

Ndërsa përmes deklaratës për garancinë e mallrave, synohet që operatorët ekonomikë të marrin përsipër detyrimin e qartë për të garantuar cilësinë e mallrave të furnizuara, duke dhënë një periudhë garancie minimale dyvjeçare.

Deklarata e garancisë shërben si instrument ligjor dhe kontraktor për Autoritetin Kontraktor, duke garantuar se mallrat e dorëzuara janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Në rast të defekteve të shkaktuara nga prodhimi, cilësia apo montimi, të ndodhura brenda periudhës së garancisë, operatori ekonomik ka detyrimin ligjor dhe kontraktor të kryejë menjëherë riparimin ose zëvendësimin e tyre, pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Vendosja e këtij kriteri synon mbrojtjen e interesit publik, sigurimin e cilësisë dhe funksionalitetit të mallrave, si dhe eliminimin e rrezikut të shpenzimeve shtesë nga ana e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Deklarata e kërkuar shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor se produktet e furnizuara do të jenë të cilësisë së kërkuar, të paprekura nga dëmtime estetike apo strukturore, dhe të prodhuara sipas standardeve në fuqi. Gjithashtu, ajo siguron se mallrat do të dorëzohen në ambientet e Autoritetit Kontraktor në gjendje të përsosur, duke eliminuar rrezikun e furnizimit me artikuj të përdorur, të konsumuar apo të dëmtuar, që do të çënonin cilësinë dhe funksionalitetin e tyre. Ky kriter është vendosur si masë mbrojtëse për interesin publik dhe për të garantuar se fondet e prokurimit do të përdoren për furnizime të reja, funksionale dhe të qëndrueshme, në përputhje me nevojat institucionale të Autoritetit Kontraktor.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesmarrës në datën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor në adresën : Banka Shqiptare e Zhvillimit sha me adresë: “Rruga Papa Gjon Pali II, Godina nr. 12, ABA Bussinnes Center kati 8, Kodi Postar 1010, Tiranë” nga një mostër, vetëm për artikujt e mëposhtëm (sipas përcaktimeve në Shtojcën 5):

Zëri 4: Komodinë me tre (3) sirtarë metalikë me çelës

Zëri 5: Karrige ergonomike me mekanizëm

Zëri 15: Karrige ergonomike drejtuesi

Zëri 24: Stol i lart termoplastik

Mostrat e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë, e cila të përmbajë: “emrin e artikullit”, “datën e zhvillimit të tenderit”, “emrin e prodhuesit/ofertuesit”, “nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik”.

Mosparaqitja e mostrave, është kusht skualifikues.

(Dorëzimi i mostrave do të bëhet me procesverbal)

Argumentimi: Ky kriter mbështetet në shkronjën a, të pikës 6 të nenit VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK për të patur një panoramë sa më të qartë të kapaciteteve zbatuese dhe përputhshmërisë së mallrave të ofertuara me specifikimeve teknike të kërkuara nga AK për mallrat që kryesorë si: Karrige rrotulluese ergonomike zyre , Komodine me tre sirtare pjesa e brendshme metalike me rrota frena dhe celes qe mbyll sirtaret, Karrige ergonomike drejtuese, Stol i larte , artikuj të cilët kanë rëndësi të madhe edhe për AK dhe njëkohësisht për shëndetin dhe mirëqënien në punë të punonjësve të institucionit. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

NJËSIA E PROKURIMIT